

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i prokurimit: “Ndërtimi rrugës “Dhimitër Xhuvani”

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 45210000-2, Punime ndërtimi.

Vlera e fondit limit: 168,306,967.95 (njëqind e gjashtëdhjetë e tetë milion e treqind e gjashtë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e shtatë pikë nëntëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 6 (gjashtë) muaj kalendarikë.

Në bazë të Nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Nenit 2, pika 2/c si dhe Nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas Shtojcës 7 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kopje të certifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare (2023, 2024, 2025) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet

si dhe te shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar. *Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

Shëmin: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “b” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 50 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr. 10091 datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar).

2.2.2 Kopje të deklaramentit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare (2023, 2024, 2025) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që po prokurohet. *Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2 dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1 dhe pika 2) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025 si dhe këstin përkatës për vitin 2026 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoritetet përkatëse sipas adresave të regjistruar në QKB. *Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021

“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar). Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”

2.2.4 Vërtetim i lëshuar nga shoqëria “Ujësjetles Kanalizime Tiranë” sha, i cili konfirmon pagesën e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kontratat e furnizimit me ujë. Kjo kërkesë duhet të përmbushet nga operatorët ekonomikë të cilët janë me seli të ushtrimit të aktivitetit ose ato që kanë të regjistruar në regjistrin tregtar adresë dytësore në territorin e Bashkisë Tiranë. Kërkesa do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me paraqitjen e një deklarate nga ana e operatoreve ekonomikë. *Autoriteti/enti Kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenin 39, pika 8 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se *”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*. Bazuar në shkresën e ardhur nga UKT sh.a., kërkohet paraqitja e një vërtetimi që konfirmon shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga kontratat e furnizimit me ujë. Bashkia Tiranë nëpërmjet “Ujësjetles Kanalizime Tiranë” sha ka si objektiv kryesor garantimin e shërbimeve jetike të furnizimit me ujë në territorin e Bashkisë Tiranë ku dhe një nga prioritetet bazë është mbledhja e të gjithë detyrimeve që rrjedhin nga kontratat e furnizimit me ujë. Qëllimi i vendosjes së këtij kriteri është për të siguruar Autoritetin Kontraktor që për dhënien e kontratës të kontraktohen operatorë ekonomik të cilët nuk kanë detyrime të pashlyera për furnizimit me ujë, me seli të ushtrimit të aktivitetit ose ato që kanë të regjistruar në regjistrin tregtar adresë dytësore në territorin e Bashkisë Tiranë, në Bashkinë e Tiranës. Vendsoja e këtij kriteri siguron institucionin e Bashkisë Tiranë edhe në rast detyrimesh të pashlyera, operatorët ekonomik kanë periudhën e nevojshme kohore për të shlyer këto detyrime përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit. Vendosja e këtij kriteri është propocion me objektin e kontratës, për sa kohë është detyrim i cdo shoqërie shlyerja e detyrimeve të shërbimeve të furnizimit me ujë në territorin ku ushtron aktivitetin, konkretisht Bashkia Tiranë.

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a.** Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

1. Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikatën e marrjes në dorëzim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim.
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikatën e marrjes në dorëzim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim;
 - Fatura tatimore përkatëse të deklaruara në organet tatimore.

1.1 Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, Operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e Bashkimit të operatorëve ekonomikë të deklaruar në fazën e tenderimit.

1.2 Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Përvoja e suksesshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe bazuar ne Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Gjithashtu referuar VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, Kreu XI, Neni 88, pika 3 citohet se: *”Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”* AK argumenton se puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave (1- a,b si dhe 1.1-1.2), të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku qartazi përcaktohet se: ***”Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.***

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: *”Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës*

që prokurohet. Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”.

AK argumenton se puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave 1- a,b si dhe 1.1-1.2, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Sqarojmë se nga praktika, gjatë fazes së vlerësimit të ofertave, AK ka hasur vështirësi në vlerësimin në mënyrë sa më të drejtë të përvojës së ngjashme, pasi jo të gjitha institucionet shtetërore apo private lëshojnë Formularin e Vlerësimit sipas formatit zyrtar (ku përcaktohet ndarja e përqindjeve). Në kuadër të vlerësimit të ofertave në mënyrë sa më të drejtë, duhet që në rastet e BOE apo Nënkontraktim, vlerësimi i përvojës të vërtetohet me paraqitjen e kontratës së bashkëpunimit; me marrëveshjen e nënkontraktimit si dhe me aktin e miratimit të nënkontraktimit lëshuar nga Institucioni. Ky dokumentacion disponohet nga çdo OE si në rastin kur ka qenë palë në Bashkimin e OE ashtu dhe në rastet kur ka qenë Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta ketë çdo kompani në dosjen e saj, për rrjedhojë nuk mund të sjellë kufizim të pjesëmarrjes së OE në tender as në mënyrë direkte dhe as në mënyrë indirekte.

Gjykojmë që kërkesa e mësipërme nuk është në kundërshtim me asnjë nga dispozitat ligjore që parashikon legjislacioni i prokurimit publik. Gjithashtu vendos në kushte të barabarta dhe u jep mundësi të gjithë OE Ofertues edhe në ato rastet kur Formularët e Vlerësimit mund të jenë të paplotesuara sipas standartit.

AK ka kërkuar këto dokumenta në përputhje me parashikimet e Nenit 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku ndër të tjera përcaktohet se: *”Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”*

2.3.2 Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Operatori Ekonomik duhet të disponojë Liçencë të shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

- N.P–1 A Punime gërmimi në tokë.
- N.P–4 C Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale.
- N.P–7 B Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi dhe vaditje.

- N.P-11 A Ndërtime për nënstatcionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.
- N.P-12 A Punime të inxhinierisë mjedisore

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

- N.S –1 A Punime për prishjen e ndërtimeve.
- N.S-2 A Punime rifiniture të muraturës.
- N.S-6 A Sinjalistika rrugore jodriçuese.
- N.S-8 A Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri.
- N.S-18 A Punime topogjeodezike.

sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Referuar kategorive të kërkuara, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve.

Për sa më lart, me qëllim realizimin e punës objekt prokurimi, është kërkuar që Ofertuesit të jenë të pajisur me Licencë profesionale për kategoritë, të cilat janë vendosur sipas volumeve të punimeve dhe vlerave që përmban Preventivi për cdo zë pune mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ku janë përcaktuar kategoritë dhe nënkategoritë përkatëse. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

N.P-1 A Punime gjërmimi në tokë

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me gjërmime në tokë, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim me kategorine *N.P-1 A*, përmbushjen e kontratës me sukses.

N.P-4 C Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale.

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me rehabilitimin ne rrugë ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me kategorine *N.P-4 C* , qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

N.P-7 B Ujësjetllës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen per Ujësjetllës, kanalizime, sistem vaditje etj, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me kategorine *N.P-7 B* , me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

NP-11 A Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen per ndricimin, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me kategorine *NP-11 A*, me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

N.P-12 A Punime të inxhinierisë mjedisore

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me punimet e nevojshme mjedisore , ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me kategorine *NP-12 A*, me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

N.S-1 A Punime për prishjen e ndërtimeve

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me punimet e prishjeve te strukturave ekzistuese, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me kategorine *NS- 1 A*, qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

N.S-2 A Punime rifiniture të muraturës

*Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me Punime rifiniture të muraturës, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me me kategorine *NS- 2 A*, qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.*

N.S-6 A Sinjalistika rrugore jodriçuese

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me sinjalistika rrugore jodriçuese si sinjalistike vertikale dhe horizontale, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me kategorine *NS- 6 A*, me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

N.S-8 A Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me me kategorine *NS- 8 A*, qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen Punime topogjeodezike, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me kategorinë NS- 18 A, me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë drejtuesin teknik (inxhinier ndertimi) të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) Librezë pune;
- b) Kontratë pune e vlefshme;
- c) Diplomë.

Ne rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe te jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varësi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkëpunimit.

Argumentimi: *Së pari*, kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Së dyti, duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.448, datë 31.07.2025 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të punimeve të ndërtimit dhe të rregullave të kantierit”, ku në nenin 8, pika 2, përcaktohet se: “... Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi”

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimi. Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohe të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohe ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dispozitave ligjore në fuqi.

2.3.4 Një punësim mesatar i të paktën **35 (tridhjetë e pesë)** personave, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar.
- b. Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar, shoqëruar me formularet e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 77, pika 4, si dhe në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, neni 39, pika 5, germa “ç”, të cilat parashikojnë të drejtën e autoritetit kontraktor për të kërkuar prova mbi kapacitetet teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomikë, në masën e nevojshme dhe proporcionale me objektin e kontratës. Si dhe në mbështetje të Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, të VKM-së nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, date 26.10.2018), të VKM-së nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve”, si dhe të Udhëzimit nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, sipas të cilave fuqia punëtore përbën një nga elementët bazë të realizimit të punimeve të ndërtimit dhe të përllogaritjes së tyre.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është të garantojë se operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore të nevojshme për realizimin e punimeve objekt prokurimi sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës, në përputhje me vëllimin, natyrën, kompleksitetin. Numri i kërkuar i punonjësve është përcaktuar bazuar në analizën e volumeve të punimeve, afatin e realizimit të kontratës dhe nevojën për organizimin e grupeve të punës që sigurojnë vijimësinë dhe cilësinë e zbatimit të punimeve. Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses

Nga ana teknike argumentojmë se numri mesatar i punonjësve, prej gjithsej 35 punonjësish, është caktuar në bazë të llogaritjeve të zërave të punës dhe volumit përkatës të cdo zëri në preventiv si dhe në zbatim të grafikut të punimeve, punime të cilat duhet të përfundojnë brenda 8 muajve kalendarikë nga data e nënshkrimit të kontratës, mbështetur në legjislacion e sipërcituar.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” sipas së cilës: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të

parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojnë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

2.3.5 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licensën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi (Profili Transport);
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknike;
- 1 (një) Inxhinier Elektrik;
- 1 (një) Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder;

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkëndim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar sipas pikës 4, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Referuar preventivi të Punimeve si dhe në bashkëndim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku është kërkuar **N.P-1, N.P-4**, është e nevojshme prezenca e **Inxhinierit të Ndërtimit**.

Referuar preventivi te Punimeve si dhe në bashkëndim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku është kërkuar **N.P-7**, është e nevojshme prezenca e **Inxhinierit Hidroteknik**.

Referuar preventivi te Punimeve si dhe në bashkëndim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku është kërkuar **N.P-11**, është e nevojshme prezenca e **Inxhinierit Elektrik**.

Referuar preventivit te Punimeve si dhe në bashkëndim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku është kërkuar **N.P-4, N.S-18** eshte e nevojshme prezenca e **Inxhinier Gjeodet/Topograf,Markshajder** pasi çdo matje që do të bëhet në funksion të objektit të prokurimit kërkon domosdoshmërisht praninë e këtij Inxhinieri.

2.3.6 Operatori ekonomik për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë staf (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licensën e shoqërisë), si më poshtë:

- 1 (një) punonjës i certifikuar si Specialist Për Testimin e Performancës së Materialeve/ Produkteve te Ndërtimit /Inxhinier Materialesh ose Operatori Ekonomik duhet të paraqesë raporte testimi laboratorike te leshuara nga laborator të akredituar për kryerjen e testimeve për materialet kryesore të ndërtimit (asfalt, beton), sipas kërkesave të projektit.

Për secilin pjesëtar të stafit të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë / Çertifikatë të vlefshme, leshuar nga institucione të licensuara /akredituara nga institucionet pergjegjese shtetërore, Librezë pune;

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit

Argumentimi: *AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “c”.*

Kriteri për stafin e mësipërm, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nga preventivi i punimeve rezulton se kontrata përfshin volume të konsiderueshme punimesh rrugore, ndër të cilat shtresa çakëlli, shtresa zhavorri, shtresa stabilizanti, shtresa binderi dhe shtresa asfaltbetoni. Këto zëra përbëjnë elementë kryesorë strukturorë të objektit të kontratës dhe ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë, performancën dhe jetëgjatësinë e investimit. Në specifikimet teknike të procedurës janë parashikuar detyrime të qarta për kontrollin e cilësisë së asfaltbetonit dhe betonit, marrjen e mostrave, kryerjen e provave laboratorike, verifikimin e treguesve fizikë dhe mekanikë, si dhe dokumentimin teknik të rezultateve të kontrollit. Në mënyrë të veçantë, specifikimet teknike parashikojnë kontroll të vazhdueshëm të cilësisë së prodhimit të asfaltbetonit dhe betonit, marrje mostrash për analiza laboratorike, kontroll të cilësisë së asfaltbetonit të shtruar dhe betonit të hedhur në vepër, si dhe mbajtjen e akteve teknike ku pasqyrohen të gjitha të dhënat e kontrollit me pamje, matje dhe prova laboratorike. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Kërkesa specifike e kërkuar jo domosdoshmërisht të përfshirë në liçensën e shoqërisë është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve. Operatori ekonomik duhet të disponojë kapacitete profesionale të mjaftueshme për monitorimin, ndjekjen dhe kontrollin e cilësisë së materialeve gjatë gjithë procesit të zbatimit të kontratës. Në këtë kuptim, disponimi i 1 (një) Specialisti për Testimin e Performancës së Materialeve/Produkteve të Ndërtimit/Inxhinier Materialeve ose Operatori Ekonomik duhet të paraqesë raporte testimi laboratorike të lëshuara nga laborator të akredituar për kryerjen e testimeve për materialet kryesore të ndërtimit (asfalt, beton), sipas kërkesave të projektit përbën një kërkesë proporcionale dhe të nevojshme për garantimin e cilësisë së punimeve duke marrë në konsideratë natyrën e objektit të prokurimit dhe kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike. Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

2.3.7 Operatori/et ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1 (një) punonjës specialist “Ekspert Zjarrëfikës në fushën e mbrojtjes nga Zjarri dhe për shpëtim” në përputhje me Ligjin Nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplomë/Certifikatë dhënë nga Drejtoria MZSH, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave ose me marrdhënie kontraktore/kontratë (të noterizuar) me qëllim ekzekutimin e kontratës objekt prokurimi (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve

ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Ekspert Zjarrëfikës në fushën e mbrojtjes nga Zjarri dhe për shpëtim").

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për *Ekspert Zjarrëfikës në fushën e mbrojtjes nga Zjarri dhe për shpëtim* është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma "c", si dhe në mbështetje të Nenit 49, pika 4 të Ligjit Nr. 152/2015, "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin", ku citohet se: "Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së jep certifikatë për personat fizikë e juridikë për ushtrimin e aktivitetit të ekspertit zjarrfikës privat, në bazë të kriterëve të veçanta të miratuara me udhëzim të ministrit".

Theksojmë se, për shkak të natyrës së punimeve që kryhen: punime elektrike, saldimi etj të cilat kanë potencial të shkaktojnë aksidenteve me rrezik zjarri kërkohet një specialist për të bërë planin e masave dhe evakuimin në raste aksidentesh ndaj zjarrit prandaj shihet e nevojshme dhe e domosdoshme prania e 1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin.

2.3.8 Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tij personel të kualifikuar/certifikuar për 1 (një) punonjës me certifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10237 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplomë/Certifikatë, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë").

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për *Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë* është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma "c", si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", sipas të cilit: „Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....“.

Autoriteti Kontraktor me vendosjen e këtij kriteri ka për qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi, në përputhje me zbatimin e rregullave në kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, sic përcaktohet në Nenin 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", sipas të cilit: „Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....“. Kërkesa për disponimin e përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë sipas certifikimit përkatës shmang dhe parandalon çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë në kantier dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë e stafit në kantier. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri është e domosdoshme pasi shërben si garanci që ofertuesit do të

realizojnë punimet në përputhje me standartet ligjore në fuqi. Funkzioni i përgjegjësit për sigurinë dhe mbrojtjen në punë ka karakter parandalues dhe mbikëqyrës. Ai përfshin identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve në vendin e punës, hartimin dhe zbatimin e masave parandaluese, monitorimin e respektimit të rregullave të sigurisë, si dhe këshillimin e punëdhënësit për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë

2.3.9 Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/certifikuar si:

- 1 (një) punonjes i pajisur me certifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga shoqëria të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplomë/Certifikatë, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. *(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave"). Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

Argumentimi:

Ky kriter është hartuar në përputhje me përcaktimet e Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 8, të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë“, sipas të cilit: „Punëdhënsi merr masa paraprake për të organizuar dhënien e ndihmës së parë,.....“. Kërkesa për disponimin e ekspertit të ndihmës së parë dhe ndërhyrjes në emergjencë gjatë proceseve të ndërtimit në kantier është i rëndësishëm pasi ndikon në mënyrë të drejtëpërdrejtë në dhënien e ndihmës së parë në rast aksidentesh në vendin e punës, ul rrezikun e pasojave ndaj jetës dhe shëndetit të punonjësve, në rast aksidenti, në kantier. Në këto kushte, është kusht ligjor vendosja e këtij kriteri pasi shërben si garanci që ofertuesit do të realizojnë punimet në përputhje me standartet ligjore në fuqi

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vertetuar me kontratë punë të vlefshme, një dokument që vërteton kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione shtetërore apo private të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republika e Shqipërisë” si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. Për stafin e mëposhtëm nuk pranohen më shumë se 2 (kualifikime profesionale/teknike), si më poshtë:

Punonjës Staf Teknik

- 1 (një) Teknik Ndërtimi
- 1 (një) Teknik Elektrik
- 1 (një) Teknik Topograf

- 2 (dy) Punonjës hidraulik
 - 2 (dy) Punonjës elektrikist
 - 2 (dy) Punonjës saldator
 - 2 (dy) Punonjës Betonues
 - 1 (një) Punonjës bojaxhi
 - 2 (dy) Punonjës pllakashtrues
- a) Për stafin teknik, ofertuesi duhet të paraqesë kontratën individuale të punës te vlefshme; dhe dëshmi/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore që të vërtetojnë kualifikimin profesional të mësipërm;
Stafi i mësipërm duhet të figurojë ne listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave
Stafi i mësipërm duhet të jete i pajisur me certificate te sigurimit teknik, e vlefshme lëshuar nga ISHTI ose nga shoqëri te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise.
- b) Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik pjesëmarres si dhe subjektet mbështetes te deklaruar nga operatorët pjesëmarres si subjekt mbështetes, duhet të deklarojnë per stafin e tyre te dhenat si me poshte:
- Per punonjesin teknik ndertimi, teknik topograf, teknik elektrik duhet te deklarohet emer/mbiemer, profili i punes, numer dhe date kontrate individuale të punës, diploma perkatese e shkolles se mesme si dhe institucioni qe ka leshuar dokumentin.
 - Per punonjesit e tjere te stafit teknik duhet te deklarohet emer/mbiemer, profili i punes, numer dhe date kontrate individuale të punës, numer dhe titull i kualifikimit per diplomën / dëshminë përkatëse, si dhe institucioni qe ka leshuar dokumentin bazuar ne Ligjin 15/2017.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punës që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të përcaktuar në specifikimet teknike. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik. Certifikimet/diplomat profesionale duhet të jenë të lëshuara nga institucione të licencuara nga organet përkatëse, mbështetur ne Ligjin Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licencuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencise Kombëtare të Arsimit,

Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialisteve duhet të jenë të regjistruara në “rregjistrat profesionale” të AKAFP-se.

Ne lidhje me 1 (një) Teknik ndërtimi prezenca e tij në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të analizës teknike.

1 (një) Teknik Mekanik prezenca e tij në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të analizës teknike.

1 (një) Teknik Topograf prezenca e tij në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të analizës teknike.

2 (dy) Punonjës hidraulik prezenca e tyre në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të analizës teknike.

2 (dy) Punonjës elektrikist prezenca e tyre në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të analizës teknike.

2 (dy) Punonjës Saldator kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të analizës teknike.

2 (dy) Punonjës betonues prezenca e tyre në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të analizës teknike.

1 (një) Punonjës bojaxhi prezenca e tyre në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të analizës teknike.

2 (dy) Punonjës pllakashtrues prezenca e tyre në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të analizës teknike.

2.3.11 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjes si me poshte:

- 2 (dy) Punonjës automakinist
- 2 (dy) Punonjës buldozerist
- 2 (dy) Punonjës eskavatorist

Për punonjesit e mesiperm, ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratën individuale të punës te vlefshme;
 - deshmite e aftësisë profesionale/patentat e manovrimi te leshuar nga DPSHTRR duhet te jene sipas modaliteteve te urdhërit Nr. 200, datë 16.5.2019 (*Në rastin kur punonjësit eskavatorist, automakinist dhe buldozeriste janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë*).
- a) Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik si dhe operatorët mbeshtetes te deklaruar nga operatorët pjesemarres si subjekt mbeshtetes duhet të deklarojnë per punonjesit e mesiperm emrin/mbiemer, profilin e punes, numrin dhe daten e kontratës individuale të punës, numrin e deshmise së aftësisë profesionale dhe afatin e vlefshmerise se saj.
- b) Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, në rastin kur punonjësit eskavatorist, automakinist dhe buldozeriste janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për

mjetet e marra me qera), operatorët ekonomik pjesëmarres duhet të deklarojnë emrin/mbiemer, profilin e punës, numrin dhe datën e kontratës individuale të punës individuale të punës, numrin e deshmive së aftësisë profesionale dhe afatin e vlefshmerisë së saj.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

2 (dy) Automakinist kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të analizës teknike.

2 (dy) Buldozerist kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të analizës teknike.

2 (dy) Eskavatorist kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të analizës teknike.

Makineritë e rënda të ndërtimit dhe emërtimet bëhen sipas Dëshmive të Aftësive Profesionale (DAP), të cilat ndahen si më poshtë :

- a) eskavator gjurmimi e ngarkimi dherash : të të gjitha llojeve si dhe fadromat e të gjitha llojeve (me goma dhe me zinxhirë), manovratorëve u jepet dëshmi për **Eskavatorist**;
- b) buldozer gjurmimi, shtyrje, nivelimi e ngjeshje dherash apo shpim toke : të gjithë llojet e traktorëve me thikë (ruspë), ose që tërheqin skreper, grejder apo nivelues, rul vibrues, shtruese asfalto-betoni, skreperët, grejderët dhe niveluesit kur janë vetëlëvizës, të gjithë llojet e traktorëve, me pajisje shtesë për ngritjen e peshave, shpimin e puseve etj., manovratorëve u jepet dëshmi për **Buldozerist**;
- c) automjete për përdorim të veçantë (APV) sipas pikës “g”, të nenit 54, të Kodit Rrugor, makineri ndërtimi mbi bazë automjeti : autovinça, autobetonierë, autopompa betoni, autobitumatriçe, autosonda, autotokmak, manovratorëve u jepet dëshmi për **Automakinist**

2.3.12 Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit (Bashkëlidhur DST) të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit për 6 (gjashtë) muaj.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 3.

2.3.13 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet (elektrike, tuba, bojra). Për materialet e kerkuara OE duhet të paraqesë katalogun/et ose skadat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen si dhe të paraqiten çertifikatë/deklaratë konfirmimit CE, certifikatat e cilesise ose raportet e testimit nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kerkuara ne Specifikimet teknike.

Operatori ekonomik duhet të specifikojë në formë tabelle: emrin e kompanisë prodhuese, emërtimin e katalogut të artikullit/produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti, emërtimin e artikullit (kodi)

nxjerrë nga manuali i prodhuesit, linku i produktit në ëeb-in e prodhuesit si dhe certifikimet përkatëse për secilin produkt.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 2 dhe pika 8, si dhe në bazë të nenit 44, pika 1 të VKM-së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Autoriteti Kontraktor kërkon që operatori ekonomik të plotësojë specifikimet e kerkuara nga projektuesit për zbatimin me cilësi të kontratës për këtë objekt. Për të krijuar bindjen e autoritetit kontraktor për realizimin me sukses të kontratës, Autoriteti Kontraktor vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizim nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributor autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë mallrat e nevojshme në këtë procedurë prokurimi. Duke qenë se materialet e kerkuara prodhohen në mënyrë industriale, certifikimi nga prodhuesi mbi parametrat e tyre është i domosdoshëm. Në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të verifikojë që specifikimet teknike të materialeve të propozuara nga operatorët ekonomik plotësojnë parametrat dhe standartet e kerkuara në specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit, duhet të paraqitet dokumentacioni i kerkuar si: certifikatë/deklaratë konfirmimit CE, certifikatat e cilësive ose raportet e testimit nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kerkuara në specifikimet teknike. Duke marrë shkas nga tipologjia e objektit të prokurimit dhe nga punimet/shërbimet që parashikohen të realizohen në preventive duhet të garantohet që mallrat të jenë sipas standarteve europiane. Operatorët ekonomik duhet të paraqesin në mënyrë të detajuar karakteristikat teknike të mallrave të përfshirë në dokumentat e tenderit, karakteristika këto që duhet të përputhen me specifikimet teknike të kerkuara nga projektuesi. Për këtë, ofertuesit duhet të deklarojnë materiale të pajisura me certifikatë konformiteti CE/certifikate cilësive etj. Me anë të venies në dispozicion në fazën e ofertimit dokumentat si kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributori, skeda teknike, certifikata cilësive, certifikata konformiteti, raporte testimi ofertuesi garanton Autoritetin Kontraktor se mallrat që do të furnizojë do të jenë sipas kërkesave të projektit.

2.3.14 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- a. Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë SSH/DIN/EN/UNI ISO 9001:2015 (e vlefshme) ose ekuivalente, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 9001:2015 ose ekuivalente.
- b. Çertifikatën e menaxhimit të mjedisit SSH/DIN/EN/UNI ISO 14001-2015 (e vlefshme) ose ekuivalente, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 14001-2015 ose ekuivalente.
- c. Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit SSH/DIN/EN/UNI ISO 45001-2018 ose certifikatën për standardin e përditësuar ISO 45001-2023, (e vlefshme) ose ekuivalente, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën SSH/DIN/EN/UNI ISO 45001-2018 ose certifikatën për standardin e përditësuar ISO 45001-2023 ose ekuivalente.
- d. Çertifikatën e menaxhimit të energjisë SSH/DIN/EN/UNI ISO 50001-2018 (e vlefshme) ose ekuivalente, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik,

Operatori ekonomik që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit do të marrë përsipër realizimin e zërave elektrikë të Preventivit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO ose ekuivalente.

- e. Çertifikatën e Sistemi i Menaxhimit Të Trafikut Rrugor SSH/DIN/EN/UNI ISO 39001:2012 (e vlefshme) ose ekuivalente, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 39001:2012 ose ekuivalente.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, nëpërputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 10 gërma "a"- "e" janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 79, pika 1 ku citohet se: *"Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë"*, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ku përcaktohet se: *"Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit"*.

Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 10 gërma "a"- "e" janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 79, pika 1 ku citohet se: *"Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë"*, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ku përcaktohet se: *"Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit"*.

SSH/DIN/EN/UNI ISO 9001:2015 ose ekuivalente, është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me SSH/DIN/EN/UNI/ISO 9001:2015 ose ekuivalente, me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

SSH/DIN/EN/UNI ISO 14001:2015 ose ekuivalente, ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me SSH/DIN/EN/UNI ISO 14001:2015 ose ekuivalente, me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

SSH/DIN/EN/UNI ISO 45001-2018 ose 45001-2023 ose ekuivalente, është standard ndërkombëtar, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me SSH/DIN/EN/UNI ISO 45001-2018 ose ekuivalente, me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

SSH/DIN/EN/UNI ISO 39001:2012 ose ekuivalente, është standart ndërkombëtar, i cili përcakton kërkesat për sistemin e menaxhimit të Sigurisë së Qarkullimit Rrugor (RTS). AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me SSH/DIN/EN/UNI ISO 39001:2012 ose ekuivalente, me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të jetë në përputhje me sistemin e qarkullimit rrugor, si dhe të reduktojë apo përjashtojë rreziqet e humbjes së jetës dhe plagosjeve të rënda në aksidentet e qarkullimit rrugor. Duke marrë shkas dhe nga natyra e objektit të prokurimit (rehabilitim ure) ku mundësia për ngarkesën e trafikut rrugor është e lartë, me qëllim minimizimin e këtij risku, është e domosdoshme që Ofertuesit të jenë të pajisur me SSH/DIN/EN/UNI ISO 39001:2012 ose ekuivalente.

SSH/DIN/EN/UNI ISO 50001-2018 ose ekuivalente, është një standard i ri i konceptuar për të asistuar kompanitë në zbatimin e një sistemi të menaxhimit të përshtatshëm për identifikimin dhe minimizimin e konsumit energjetik. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me SSH/DIN/EN/UNI ISO 50001:2018 ose ekuivalente, me qëllim që veprimtaria e ushtruar (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi), të reduktojë kostot energjetike të kompanive, emisionet e gazrave serë (GHG) dhe impaktet e tjera në mjedis. Në Preventivin e punimeve parashikohen zëra elektrik, ku zbatimi i tyre kërkon që Ofertuesi të jetë i pajisur me Certifikatë SSH/DIN/EN/UNI ISO 50001-2018 ose ekuivalente. Në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu XI, Neni 88, pika 3, cilësohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje”. Për sa më lart, Njësia e Prokurimit, gjykon se, kjo kërkesë në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik duhet të përmbushet nga Shoqëria e cila referuar Marrëveshjes së Bashkëpunimit ka marrë përsipër të realizojë zerat elektrike të pasrashikuara sipas Preventivit.

AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Certifikatat e kërkuara sipas pikës 12 gërma “a”- “e”, është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Certifikatat e kërkuara janë në përputhje me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve. Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari

ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues

2.3.15 Operatori Ekonomik duhet të disponojë Liçense të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) Kodi III.2.B (Për grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta), së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar, e shoqëruar me Aktin e Miratimit e cila duhet të përmbajë kodin 17.09.04. Çertifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ku parashikohet se: “leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji” dhe VKM Nr.402, datë 30.06.2021 “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”.

Në raportin paraprak të vleresimit të ndikimit në mjedis është listuar edhe “Menaxhimi i mbetjeve”. Në nenin 57/2 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Qendra Kombëtare e Licencimit lëshon licencën për transportin e mbetjeve, e cila përfshihet në nënkategorinë III.2.B të fushës III të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, pas miratimit të saj nga ministri”. Ndërkohë, sipas VKM nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta: Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”. Referuar VKM nr. 402, datë 30.06.2021, ‘Për miratimin e katalogut të mbetjeve’, kodi 17 09 04 klasifikohet në grupin 17 “Mbetje nga ndërtimet dhe prishjet”. Për rrjedhojë, kërkesa që operatori ekonomik të disponojë licencën përkatëse për grumbullimin dhe transportin e këtyre mbetjeve lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe synon të garantojë që largimi i mbetjeve të kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekte të autorizuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie.

2.3.16 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi
1	Asfaltroshtuese	copë	2	Në pronësi ose me qera
2	Autobitumatrice	copë	2	Në pronësi ose me qera
3	Autobot	copë	1	Në pronësi ose me qera
5	Autobetonere	copë	1	Në pronësi ose me qera
6	Eskavator me goma	copë	1	Në pronësi ose me qera
7	Minieskavator	copë	1	Në pronësi ose me qera

8	Gazogjen	copë	1	Në pronësi ose me qera
9	Grejder	copë	2	Në pronësi ose me qera
10	Rul (Kompresor me vibrim)	copë	2	Në pronësi ose me qera
11	Saldatrice elektrike/Elektrosaldatrice	copë	1	Në pronësi ose me qera
12	Fadromë	copë	1	Në pronësi ose me qera
13	Vibrator	copë	1	Në pronësi ose me qera
14	Makineri për vizime në rrugë	copë	1	Në pronësi ose me qera
15	Makineri për skarifikim shtresash rrugore	copë	1	Në pronësi ose me qera
16	Kamion me kapacitet 10- 20 ton	copë	2	Në pronësi ose me qera
17	Kamioncine me kapacitet 3-5 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera

Pajisjet dhe mjetet nuk duhet të jenë të angazhuara në asnjë kontratë tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti.

- a. Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit: (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikatë e kontrollit teknik (e vlefshme); d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).
- b. Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) çertifikatën e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).
- c. Për mjetet e deklaruar që transportojnë mallra të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqitet çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet përkatëse (e vlefshme).
- d. Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.
- e. Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qartë dhe të dallueshme për secilin mjet të deklaruar, ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- f. Për mjetet që sipas percaktimeve ligjore të qarkullimit rrugor nevojitet targa, leje qarkullimi...etj. Operatori ekonomik duhet të deklarojë në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në rubriken përkatëse të dhënat për mjetet e kërkuara në shtojcën 8.
- g. Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara, do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të

angazhuara në kontrata të tjera me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Tiranë, afati i zbatimit të cilave nuk ka përfunduar përbëjnë shkak skualifikimi.

- h.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë, me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.
- i.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur në mbështetje të nenit 77, pika 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, si dhe Kreut V, Seksioni III, nenit 39, pika 6, germa “d”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, sipas të cilave operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se kanë në dispozicion mjetet, pajisjet teknike dhe kapacitetet e nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Për përcaktimin e llojit dhe numrit të mjeteve/makinerve të kërkuara janë marrë në konsideratë natyra e objektit të kontratës, zërat e preventivit, specifikimet teknike, volumi i punimeve dhe afati i realizimit të kontratës. Këto mjete janë të lidhura drejtpërdrejt me proceset ndërtimore që do të kryhen dhe janë të nevojshme për garantimin e cilësisë, sigurisë dhe realizimit të punimeve sipas grafikut të zbatimit. Përcaktimi i mjeteve dhe pajisjeve teknike mbështetet në legjislacionin e fushës së ndërtimit, konkretisht në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, në VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve”, si dhe, për aq sa është e aplikueshme, në VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, të ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018. Dokumentacioni i kërkuar për mjetet në pronësi ose me qira, si akt pronësie, leje qarkullimi, certifikatë kontrolli teknik, siguracion, kontratë qiraje, dokumentacion teknik, fotografi, deklaratë vendndodhjeje dhe deklaratë për verifikim nga Autoriteti Kontraktor, ka për qëllim të provojë disponueshmërinë reale, vlefshmërinë ligjore dhe gjendjen funksionale të mjeteve të deklaruara dhe synon garantimin e kapaciteteve teknike të nevojshme për përmbushjen me sukses të kontratës. Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Në të gjitha rastet kur AK në specifikimet teknike i është referuar vetëm standarteve europiane, Autoritetit Kontraktor do të pranojë edhe paraqitjen e standarteve SSH/DIN/UNI/EN/ISO.

Shënim:

Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit kontraktor. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese Autoriteti Kontraktor ka të drejte të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vertetesinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si me siper ose të kerkoje operatorit sqarime dhe dokumente mbeshtetese per keto sqarime ne perputhje me nenin 24 pika 1 te VKM nr.28 date 19.05.2021 per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik.

Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të plotësojnë formularin e ofertës, sipas kërkesave të përcaktuara në shtojcën 1, pjesë e këtyre dokumenteve të tenderit.

Gjithashtu Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të plotësojnë edhe preventivin e punimeve i cili është vënë në dispozicion nga autoriteti kontraktor, pjesë e këtyre dokumenteve të tenderit.

Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, sjellim ne vemendje se:

- Autoriteti Kontraktor do të beje verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetedeklarimet e bera në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar perben kusht s’kualifikimi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe Nenit 39, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të Nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.